

VENDIM
Nr. 163, datë 19.2.2020

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 707, DATË 21.11.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN TË DISA PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË VIJËN BREGDETARE SHKODËR–FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 34, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën e vendimit nr. 707, datë 21.11.2018, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 9 shtohet pika 9/1, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCË

9/1. Zona kadastrale, 1925 Durrës (Hamallaj)

ZK	Nr. pasurie	Vol.	Faqe	Lloji	Sipërfaqja (m² ose ha)	Pronësia
1925	52/1	4	207	arë	8,000.00	shtet
1925	52/2	4	208	pyll	7,300.00	shtet
1925	52/3	4	209	arë	10,200.00	shtet
1925	52/4	4	210	pyll	10,500.00	shtet
1925	53/1	4	211	arë	153,800.00	shtet
1925	53/2	4	212	arë	158,300.00	shtet
1925	53/3	4	213	kënetë	30,600.00	shtet
1925	54/1	4	214	arë	105,500.00	shtet
1925	54/2	4	215	arë	105,500.00	shtet
TOTALI					589,700.00	